REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 103/20
Datë/Datum. 14.02.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Për: **Kompania Rajonale e Ujësjellësit "GJAKOVA" SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr1 i prokurimit	**KRURGJA-20-4-2-2-1**
Nr i brendshëm	**KRURGJA -20 -001-221**

Sa i përket tenderit për: **Mbikqyrja dhe monitorimi i stacioneve të pompave në zonat rurale për nevojat e Kru „Gjakova" sha**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Grup i Operatorëve Ekonomik: "AGE group" Sh.p.k. & N.N.P. "AS – ING"
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Avdulla Bugari p.n.
(Adresa)

Rahovec — **21000**
(Vendi) — *(Kodi postar)*

+383 44 233 331 — **N/A**
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Tahir Bala
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

agegroup@hotmail.com
(Adresa elektronike)

14.02.2020
(Data e parashtrimit të kërkesës)

export-import AGE group SH.P.K. RAHOVEC

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftim për Kontratë si dhe Dosja e tenderit: 08.01.2020 (publikuar në E-prokurim)

Hapja e ofertave: 21.01.2020 ora: 13:00

Njoftim për tenderuesin e eleminuar: 28.01.2020 (përmes platformës E-prokurimit)

Njoftim për Vendimin e AK – së: 28.01.2020 (përmes platformës E-prokurimit)

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒

Hapja e tenderit është bërë në formë elektronike dhe mendojmë qe procesi ka shkuar në rregull.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëvejeve:

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pran AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ Jo ☐

Kemi bërë kërkesë për rishqyrtim mirëpo kërkesa jonë është shpallur si e pabazuar nga AK

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ne mendojmë se AK ka bërë shkelje të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, referuar si LPP:

Neni 1 i LPP – së – Qëllimi
Neni 6 i LPP – së – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 i LPP – së – Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 59 i LPP – së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 72 i LPP – së – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
Neni 39 i RrUOPP – së – Sqarimi i Tenderëve
Neni 41 i RrUOPP – së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Me datë: 28.01.2020, AK ka publikuar: B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETI KONTRAKTUES" përmes platformës e-prokurimi.rks-gov.net, ku e ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundërshtim me nenin 7, 59 dhe 72 të LPP – së, si dhe nenin 39 dhe 41 të RrUOPP – së, ku na keni eliminuar neve nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se: Sipas pikës III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional te njoftimi për kontratë: *Operatori Ekonomik duhet te ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku një (1) shërbim të natyrës së ngjashme në tri vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate.*
Ju njoftojmë se referencat e prezantuara nga ana juaj nuk korrespondojnë me natyrën e këtij aktiviteti qe ka te beje me (Lëshuarja ne pune e pompave, Kontrollimi i panelit elektrik, Kontrollimi i pompave dozuee te klorit, Kontrollimi i pjesëve lidhëse te pompës dozuese te klorit. Përgodituja e tretjes se klorit te lëngët në raport 1 : 3, Matja e klorit të lirë në disa pika etj).

AK ka vepruar në kundërshtim me Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së tenderit, pasi që është kërkuar: *Operatori Ekonomik duhet te ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku një (1) shërbim të natyrës së ngjashme ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate,* dhe ne si Operator Ekonomik e kemi plotësuar këtë kriter.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore qe u përmenden me lart, kërkojmë nga AK – ja qe te merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e Grup i Operatorëve Ekonomik: "AGE group" Sh.p.k. & N.N.P. "AS – ING" si e bazuar
ANULOHET Njoftim dhe Vendim i AK – së për anulim aktiviteti dhe lënda kthehet në RIVLERESIM
DETYROHET autoriteti kontraktues që Rivlerësimi i ofertave të bëhet konform dispozitave të LPP – së dhe kërkesave të FTD – së dhe Njoftimit për Kontratë.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne mendojmë se eliminimi i kompanisë tonë, ka shkaktuar dëme në aspektin financiar e po ashtu edhe në atë të imazhit dhe profilit të kompanisë.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës", apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit, 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*